

ndaj lagjes së Jasharajëve. Në sulmin, i cili u krye më 22.01.1998, u plagosën vajza e Hamzës, Selvetja, dhe vajza e Rifatit, Ilirjana. Pas këtij sulmi, shumë burra të fshatit shkuan në mbrojtje të familjes Jashari, në mesin e tyre edhe vëllai i Zahides, Osman Geci.

Herët në mëngjes, më **5.03.1998**, Reparti i 37 i Njësiteve të Posaçme Policore [NJPP] e ka vendosur rrethimin e parë të **Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze**, në distancë prej afro 300 metrash nga shtëpitë e para të fshatit. Njësitet speciale policore të Serbisë: NJPP, NJSA [Njësitet Speciale Antiterroriste] dhe NJOS [Njësitet për Operacione Speciale], i shfrytëzonin disa dhjetëra autobllinda dhe tanke për shkatërrimin e fshatit. Milorad Luković-Legija ishte drejtpërsëdrejti në krye të njësiteve të NJOS-it. Policët e kishin urdhrin që ta vrisnin çdo shqiptar, pa marr parasysh nëse bëhej fjalë për fëmijë, gra apo persona të moshuar, nëse tentonin të braktisnin apo depërtonin në fshat.

Duke hapur zjarr në mënyrë të njëpasnjëshme nga armët automatike, mitralozat dhe tanket, policia e ftoi familjen Jashari që të dorëzohet. Shabani, Ademi dhe Hamza e kanë organizuar mbrojtjen, në të cilën, përveç burrave dhe djelmoshave të familjes së Shaban Jasharit, kanë marrë pjesë edhe burrat nga *Mëshalla Jashari* në Prekaz të Poshtëm/Donje Prekaze, si dhe nga fshatrat e tjera. Në mesin e tyre ishin edhe Sherifi, Faiku, Aliu dhe Sinani. Gratë dhe fëmijët: Zahidja e moshëthyer; bashkëshortja e Ademit, Adilja me fëmijët Fitimin dhe Kushtrimin; bashkëshortja e Hamzës, Feridja, me fëmijët Besartën, Selveten, Afeten, Lirijen, Fatimen, Blerinën, Blerimin dhe Besimin, si dhe bashkëshortja e Rifatit, Zarifa, me fëmijët Hidajeten, Igballen, Valdetin dhe Igballin, qëndronin së bashku në një pjesë të bodrumit. Kohë pas kohe, disa nga gratë dilnin nga bodrumi në oborr apo u ngjitnin shkallëve të shtëpisë, duke i shpërndarë municionet apo duke shtënë.

Ditën e parë, u vra bashkëshortja e Ademit, Adilja, në çastin kur po kthehej nga kati i shtëpisë në bodrum. Familjarët e kanë bartur trupin e saj në bodrum dhe e

kanë mbuluar me një batanije. Në mbrëmjen e ditës së parë të sulmit, djali i Rifatit, Bashkimi, dhe kushërinjtë Ragipi dhe Bilalli, gjendeshin në pozicionin pranë shtëpisë së tretë të Jasharajëve. Lëvizën për pak drejt skajit të zonës së luftimeve dhe nuk ishin më në zonën e cila i ishte ekspozuar armëve të zjarrit. Por, as nuk mundnin të ktheheshin më. Shkuan në Mikushnicë/Mikušnica, ku i ka strehuar Kamber Manxholli.

Ademi, Shabani, Hamza dhe burrat e tjerë kanë rezistuar për tri ditë rresht. Gjatë bombardimeve më të furishme në mëngjesin e ditës së shtunë, më **7.03.1998**, shtëpia gati u shkatërrua e tërë nga granatat dhe plumbat. Madje, edhe muret e bodrumit u qanë. Në bodrum, ku strehoheshin gratë dhe fëmijët, të gjithë kanë pësuar nga eksplodimet e predhave përveç vajzës së Hamzës Jasharit, Besartës, njëmbëdhjetë vjeçe. Adem Jashari ka rënë përderisa e mbronte hyrjen në bodrum. Besarta e kishte parë atë kur ka rënë pranë shkallëve të shtëpisë. Pas vrasjes së Ademit, i biri Kushtrimi doli nga bodrumi dhe u nis drejt oborrit të shtëpisë së dytë të Jasharajëve. E kanë vrrarë përderisa vraponte përmes oborrit. E kishte pushkën automatike në dorë.

Në mëngjesin e datës 7.03.1999, policët filluan t'i mblidhnin trupat e shqiptarëve të vrrarë. Në atë çast, në skenë u paraqiten komandanti i Repartit të 37 të NJPP-së Radoslav Mitrović dhe Goran Radosavljević, i quajtur Guri, komandant i grupeve ndjekëse operative të MPB-së së Serbisë. Policët lëviznin me autobllindat e tyre të tipit *Pinzgauer* dhe kamionin e tipit *Dajc*, me ceradë të ngjyrës së kaltër, pranë shtëpive të shkatërruara dhe të djegura, duke i futur trupat e shqiptarëve të vrrarë në kamion. Të paktën 30 trupa të shqiptarëve të vrrarë u bartën me këtë kamion. Trupat e tjerë u bartën me makina. Policët i kanë futur trupat e të vrrarëve nëpër arkivole druri. Pastaj, i bartën në oborrin e depos së materialit dhe pajisjeve ndërtimore *Lah Tushila*, e cila gjendej përmbi fshat. Më pas, policia i ka ftuar familjarët e të vrrarëve që të shkonin dhe t'i merrnin trupat e viktimave, por pak kush u përgjigj në këtë ftesë. Në